



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 94.
Prishtinë, më 8.04.2014 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Hatim Baxhaku Saša Milosavljevič, Jelena Bontic, Petar Miletić Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Mungoi: Jasmina Živković dhe Glauk Konjufca.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuese e OSB-së, Lejla Selimi, përfaqësues nga ECMI -Trim Kabashi, predstavnica ECM-a Trim Kabashi, përfaqësuesi i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Elmi Reçica** –zëvendëskryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-227 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuse, me amandamente të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
5. **Shqyrtimi i Rekomandimeve lidhur me funksionimin e Agjencioneve dhe Rregullatorve të Pavarur që i raportojnë Kuvendit;**
6. **Te Ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja– konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-227 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion;

Kryesuesi- paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 04/L-227 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike me Raport amendamente të Komisionit Funksional dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në përfundim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P e r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-227 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuse, me amandamente të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

Kryesuesi- paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuse me Raport amendamente të Komisionit Funksional dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në përfundim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Petar Miletic- pajtohet për miratimin e këtij raporti të komisionit funksional por kishte vërejtje lidhur me emërtimin e ligjit dhe të verifikohet fjala antidamping.

Kryesuesi – pajtohet me këtë vërejtje dhe propozoi të epen sugjerime në komisionin funksional, kur bëhet fjalë për interpretimit gjuhësor të emërtimit të këtij Ligji.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P e r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjit nr. 04/L-240 për masat antidamping dhe masat kundërbalancuse dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, me amendamentet e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;

Kryesuesi- paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti me Raport amendamente të Komisionit Funksional dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në përfundim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Petar Miletic- Sa i përket këtij Ligji, komuniteti jonë ka dilema dhe vërejtje me nenin n22, pika 1,2 nga se komuniteti jonë nuk ka marr informata dhe fakte bindëse nga Ministri dhe kryetari i komisionit funksional, se do të gëzojnë të drejtën e pensionit bazik të moshës të gjithë qytetarët e komunitetit serbë. Deklarohet se komuniteti serb, nuk do të votojë raportin e komisionit funksional lidhur me Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Kryesuesi – theksoi se të gjithë jemi në dijeni se Projektligj ka kaluar në disa faza dhe është arrit të bëhet plotësim ndryshimi i tij. Kemi marr vërejtje pse komisioni jonë ka penguar aprovimin e tij në Kuvend. Ai shprehu qëndrimin e tij se Komisioni duhet të miratoj Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe duhet raporti të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në komisioni funksional.

Albert Kinolli – tha se respekton mendimin e zot. Miletic pasi në demokraci vota është e lirë. Mirëpo ai kishte mendim tjetër lidhur raportin e komisionit funksional, nga se komisioni ka ftuar ministrinë e MPMS si sponsorues të projektligjit dhe kryetarin e komisionit funksional, të cilët kanë dhënë sqarime shtesës se amendamenti 19 nuk dëmtohen pjesëtarët e asnjë komuniteti i cili jetojnë në Kosovë.

Lumnije Morina - pajtohet plotësisht me diskutimin e parafolësit se në takimin e përbashkët me ministrin dhe kryetarin e komisionit janë eliminuar të gjitha vërejtjet që ishin të diskutabile. Ajo, njëherit kërkoi nga anëtarët e komisionit, të miratohet raporti i komisionit funksional.

Mursel Halili –, tha se ishte prezent në takim me ministrin Rasic, i cili dha sqarim se neni 22 nuk është kontestues. Ai pajtohet me propozimin e zonjës Morina, se Projektligji duhet të miratohet në Kuvend.

Hatim Baxhaku – sa i përket këtij projektligji nuk bëhet fjalë për pensione kontribuuese por për pensiononin themelor të pleqërisë. Me këtë projektligj nuk do të paraqiten probleme për personat e shpërngulur, kërkesa e vetme është se ata duhet të lajmërohen çdo 6 muaj apo së paku një herë në vit. Ai pajtohet për miratimin e raportit të komisionit funksional.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Rekomandimeve lidhur me funksionimin e Agjencioneve dhe Rregullatorve të Pavarur që i raportojnë Kuvendit;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi rekomandimet e Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, lidhur me funksionimin e Agjencioneve dhe Rregullatorve të Pavarur që i raportojnë Kuvendit dhe vendosi që Komisionit funksional, t'i paraqet këtë:

Rekomandim

1. Miratohen rekomandimet në lidhje me funksionimin e Agjencioneve dhe Rregullatorëve të Pavarur që i raportojnë Kuvendit me konstatim se nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetar i parë i Komisionit

Elmi Reçica